

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Veliaj u la në burg, mbrojtja e kryebashkiakut për vendimin e Gjykatës së Lartë: Jashtëzakonisht shqetësues
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/veliaj-u-la-ne-burg-mbrojtja-e-kryebashkiakut-per-vendimin-e-gjykates-i46582
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 10:38:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 10:13:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3f95676e6dbe073dc35721f05ea80ad2366f625806d0a48cc160ff02d7753d18
TEKSTI	ac62a2545a53e9d131948b9b94c43482c86f9e794df17b18997d62d4fd4f6e60
PAMJA	3472cc901bd7b12e3179e9d03f3d908a83483ec88c1948f6c5e5fa787029ddc8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	25d3b9218568d5b471c3c22eb671365481d8021b7aee28fcc018ec01ecfef636
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	93a0feb7bb19154a540f480bce1eeee0b2224e0180d4198842f090d06654d15a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.


Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/25d3b9218568d5b471c3c22eb671365481d8021b7aee28fcc018ec01ecfef636>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Gjykata e Lartë lë në qeli Erion Veliajn, qytetarët protestuan kundër lirimit të tij! Avokati: Vendim shqetësues](#)

15 Shtator 2026, 11:18

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZINë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-
-

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 15 Shtator 2026, 12:13

Veliaj u la në burg, mbrojtja e kryebashkiakut për vendimin e Gjykatës së Lartë: Jashtëzakonisht shqetësues

Sipas Ndrecës, ky vendim ka shkelur efektin detyrues të Gjykatës Kushtetuese e cila e konsideroi masën e sigurisë si "jo proporcionale".





Pas vendimit të Gjykatës së Lartë për lënie në burg të Erion Veliajt, ka reaguar avokati i kryebashkiakut. Një postimi në rrjetet sociale, Plarent Ndreca e cilësoi vendimin "jashtëzakonisht shqetësues" duke pretenduar se ishin shkelur garancitë kushtetuese.



Gjykata e Lartë lë në qeli Erion Veliajn, qytetarët protestuan kundër lirimit të tij

15 Shtator, 11:30

Ndërsa shtoi se do të vijojë përpjekja me çdo mjet juridik për lirimin e Veliajt.

"Vendimi i sotëm i Gjykatës së Lartë përbën një zhvillim jashtëzakonisht shqetësues për shtetin e së drejtës, sigurinë juridike, të drejtat themelore dhe mbi të gjitha, për demokracinë në këtë vend. Duke lënë në fuqi një vendimmarrje të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, ky vendim praktikisht ka lënë pa efekt detyrues vendimin e autoritetit më të lartë kushtetues të vendit.

Sigurisht, do ta analizojmë me përgjegjësi arsyetimin e plotë. Por rezultati i shpallur sot ngre një pyetje dramatike: çfarë vlere kanë garancitë kushtetuese nëse vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk zbatohen efektivisht? Kur një përfundim i tillë nuk gjen shpjegim bindës në Kushtetutë dhe në ligj, atëherë shkaqet duhen kërkuar përtej argumenteve juridike dhe jashtë sallës së gjyqit.

Pasojat shkojnë përtej një procesi individual. Ato mbajnë peng ushtrimin e mandatit të kryetarit të zgjedhur të Bashkisë së Tiranës, funksionimin normal të institucionit dhe vullnetin e qytetarëve të shprehur me votë. Prej 19 muajsh, qytetarët e Tiranës janë privuar nga kryetari që kanë zgjedhur. Z. Erion Veliaj prezumohet i pafajshëm dhe vazhdon të mbahet në paraburgim, ndonëse hetimi ka përfunduar prej një viti dhe çështja ndodhet në gjykim.

E gjithë kjo nuk është arsye për t'u dorëzuar, por për ta vijuar betejën. Mund ta izolojnë dhe t'i kufizojnë mundësinë për të folur, por nuk mund ta mundin politikisht nëpërmjet vendimeve gjyqësore. Një politikan mundet me votë, përballë qytetarëve, dhe jo përmes "lawfare"-it.

Ne do të përdorim çdo mjet juridik që parashikon Kushtetuta, ligji dhe instrumentet ndërkombëtare.

Shqipëria meriton një drejtësi të standardeve evropiane, e cila garanton të drejtat, respekton vendimet kushtetuese dhe mbron demokracinë, mjetin më të lartë që qytetarët kanë në dorë për të vendosur se kush i përfaqëson dhe kush e drejton vendin"- shkruan Ndreca. **Versus.al**

Tags:

[plarent ndreca](#) [erion veliaj](#)

Poll



Pjesë e grupit të Avdylajve të Shijakut, kapet në Belgjikë Jasin Avdyli! I dënuar për dosjen 339 dhe 'Volvo 4'

15 Shtator 2026, 11:54

^ekstrakti^



AKTUALITET

Korrupsion dhe shpërdorim detyre, kapet në flagrancë polici në Durrës! Procedohen penalisht 2 kolegët e tij

15 Shtator 2026, 11:35

^ekstrakti^



AKTUALITET

Gjykata e Lartë lë në burg Erion Veliajn

15 Shtator 2026, 11:00

^ekstrakti^




AKTUALITET

"O gjykatës bëj drejtësi, lër Veliajn në qeli", qytetarët protestojnë para Gjykatës së Lartë

15 Shtator 2026, 10:39

^ekstrakti^






AKTUALITET

[Tentativa për mosbindje civile, 12 protestues të arrestuar! Policia: U bënë thirrje nxënësve për bojkot të mësimit](#)

15 Shtator 2026, 10:20

^ekstrakti^




AKTUALITET

[Daja i Zegjine Çaushtit u arrestua për pl*gosjen e ish-vjehrrit, flet ish-gruaja: Më dh*nonte dhe kërcënonte](#)

15 Shtator 2026, 10:02

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Tentativë vr*sje, drogë e spiunazh brenda policisë, GJKKO jep dënimet për Durim Bamin, Aldo Avdylin dhe 5 të tjerë](#)

15 Shtator 2026, 09:30

^ekstrakti^



AKTUALITET

[U arrestua në Greqi për 100 kg kokainë mes trëndafilave, "i tmerrshmi i Beratit": S'kam lidhje, jam i pafajshëm](#)

15 Shtator 2026, 09:11

^ekstrakti^

[Të fundit](#)





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.